- (c) **“Mospranim”** është mosparaqitja e një pjesë ose e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.

2. Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet.

F. VLERËSIMI I OFERTAVE

19. Kualifikimi i Operatorit Ekonomik

1. Për një pjesë të kriterëve të pranimit të kërkuara në dokumentat e tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si një provë paraprake në formën e një deklarate, ku shprehet se Oferta e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit.

2. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. Operatori ekonomik mund të përdorë një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të gjitha kriteret, për të cilat nuk lejohet vetëdeklarim.

Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

4. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

20. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

1. Autoriteti/Enti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

Opsioni 1) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:

Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të koston, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

$$P_o = P_{k1} + P_{k2} + P_{k3} + \dots$$

P_o - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

$P_{k1}/P_{k2}/P_{k3}/\dots$ - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës.

a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomike më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$P_{k1} = V_{mink1} \times P_{maxk1} / O_{k1}$$

P_{k1} _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomike më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$P_{k1} = O_{k1} \times P_{maxk1} / V_{maxk1}$$

V_{maxk1} _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Opsioni 2) – Oferta Ekonomike më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHENIM: 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kriter vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomike më e favorshme.

Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës.

21. Konvertimi në valutë të vetme

22.Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe i ofertës anomalisht të ulët

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- | | |
|---|--|
| 23. Njoftimi i Fituesit | 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese. |
| 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/Kontratës | <p>1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.</p> <p>2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.</p> <p>Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor; b) garanci bankare; c) garanci nga shoqëri sigurimi. |

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike..

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin përfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të pafuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbyshjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1- Blerje materjale për Gjelberimin		
Nr	Emertimi	Specifikimet teknike
1	Disqe per motorrat e barit	Disk per prerese bari, N2, 205 x 25.4 mm, 3 dhembe
2	Koka filispanje	Koke motokose bari me 2 mm dhe 3 mm. koke prerese (5 majtas - 7.1 djathtas), e paisur me tel bari (4.9 majtas / 5.7 djathtas), me teh sharre (5.8 majtas - 4.6 djathtas)
3	Boje zmalto	Paketim: 0,75l; mbulimi: 12-14 m ² ; hollimi: me 25% brenda 8 oresh; koha e tharjes: 30min; ngjyra: te ndryshme.
4	Boje antiruzhe (kunder ndryshkut)	Paketim: 0,75l; mbulimi: 5-10 m ² ; hollimi: me 25% brenda 8 oresh; koha e tharjes: 30min.
5	Filispanje per motaorin e barit Ø0.2mm 100m	Fije per prerese bari 2 mm x 48 m katrore
6	Tel bari	Materiali: Hekur; diametri: 1,2mm; pesha: 20kg/ ruloni. Lehtesisht I punueshem.

7	Zingjir per motorseke	Zinxhire motorsharre 16"/40cm. Përdoret për të prerë në të gjitha llojet e drurit. E përshtatshme për të gjitha motorsharrat që e kanë gjatesinë e lamës 40 cm. Dhëmbë te ndërtuar prej çeliku special sigurojnë qëndrueshmeri të lartë, prerje të shpejte dhe efikase. Rezistent ndaj temperaturës së lartë dhe korrozionit.
8	Zorre uji per vaditje	Paketimi 50 Meter Linear / Bobinë Gjeresia 1/2 3/4 1
9	Stabilizant	Stabilizant tradicional - bazë standarte për shumicën e mbulesave për dekada të tëra, I nxjerre nga guroret me përmasa 0.5mm.
10	Granil	Granil me përmasa 0.5-3mm
11	Rane e lare lavatriçe	Rere e lare ne lavatriçe te jete rere me madhesi kokrizash 0.06 mm–2mm.
12	Çimento 32.5 R	Çimentoja te jete e markes 32.5R, pa lageshtire, e mirepaketur ne thase 25kgdhe e shoqeruar me çertifikaten perkatese.
13	Bordura betoni 15x30x100	Permasa: 15 cm x 100 cm , lartesia: 30 cm , ngjyra: gri
14	Bordura betoni 10x20x100	Permasa: 10 cm x 100 cm , lartesia: 20 cm , ngjyra: gri
15	Gelqere pluhur	Paketimi: 25 kg. Ngjyra e bardhe

2- Blerje materiale për Varrezat

Nr	Emertimi	Specifikimet teknike
1	Çimento 32.5 R	Çimentoja te jete e markes 32.5R, pa lageshtire, e mirepaketur ne thase 25kgdhe e shoqeruar me çertifikaten perkatese.
2	Rane e lare lavatriçeje	Rere e lare ne lavatriçe te jete rere me madhesi kokrizash 0.06 mm–2mm.
3	Elektroda 2.5 mm	Elektrodat e celikut duhet te jene te pershtatshme per procesin e saldimit ne materiale celiku permasat e elektrodes : Gjatesia 300 mm , Diametri 2.5 mm, Paketimi deri ne 4 kg.
4	Rrjete rrethimi 1.5m i larte	Materiali: Celik i zinkuar: Gjatësia: 20 m:Lartësia: 1 m:Dimensioni i telit: Ø1.6 mm
5	Zingjir per motorseke	Zinxhire motorsharre 16"/40cm. Përdoret për të prerë në të gjitha llojet e drurit. E përshtatshme për të gjitha motorsharrat që e kanë gjatesinë e lamës 40 cm. Dhëmbë te ndërtuar prej çeliku special sigurojnë qëndrueshmeri të lartë, prerje të shpejte dhe efikase. Rezistent ndaj temperaturës së lartë dhe korrozionit.
6	Profile te ndryshme per rrethim	Te jete brenda standarteve te lejuara per perdorim, te mos jete i ndryshkur, si dhe te shoqerohet me çerfikaten e cilesise dhe te rezistences se tij.
7	Tel xingat	Materiali:xingat me veti te mira mekanike dhe fortesi jo me pak se 70kN/m2.; seksioni:0,5cm.
8	Disqe per motorrat e barit	Disk per prerese bari, N2, 205x25.4 mm, 3 dhembe
9	Koka filispanje	Koke motokose bari me 2 mm dhe 3 mm.koke prerese (5 majtas - 7.1 djathtas), e paisur me tel bari (4.9 majtas / 5.7 djathtas), me teh sharre (5.8 majtas - 4.6 djathtas)
10	Boje zmalto	Paketim: 0,75l; mbulimi: 12-14 m²; hollimi: me 25 % brenda 8 oresh; koha e tharjes: 30 min; ngjyra: te ndryshme.

11	Boje antiruzhe (kunder ndryshkut)	Paketim: 0,75l; mbulimi: 5-10m ² ; hollimi: me 25% brenda 8 orësh; koha e tharjes: 30min.
12	Filispanje per motaorin e barit Ø0.2mm 100m	Fije per prerese bari 2 mm x 48 m katrore
13	Tel bari	Materiali: Hekur; diametri: 1,2 mm; pesha: 20kg/ ruloni. Lehtesisht I punueshem.
14	Gelqere e shuar	Paketimi: me qese 15 -17 kg. vjetersia:te jetë e shuar mbi dy vjet.

3- Blerje materjale Asfalt te ftohtë

Nr	Emertimi	Specifikimet teknike
1	Prajm Bitumi	Hidoizolues bituminoz me përbërje verniku. Pesha 0.97kg/liter. Mbetja e destiluar 50-65%
2	Asfalto beton I ftohte	Agregati duhet te perbehet nga zhavorri me shkallezim te perfshire midis 3mm dhe 6mm, me shtimin e nje perqindje prej 0/4rere, krejtesisht e paster dhe e thate.Agregati duhet te perdoret ne temperature maksimale 100C.Lidhesi (bitumi) preferohet te jete I perbere nga bitum me penetrim 70/100.
3	Granil I fraksionuar	Granil me permasa 0.5-3mm

4- Blerje materjale për KUB-në

Nr	Emertimi	Specifikimet teknike
1	Zhavorr	Të jetë i sigur dhe të mos ketë materjale të huaj
2	Rane e lare lavatriçe	Rere e lare ne lavatriçe te jete rere me madhesi kokrizash 0.06 mm–2mm.
3	Çimento 32.5 R	Çimentoja te jete e markes 32.5R, pa lageshtire, e mirepaketur ne thase 25kgdhe e shoqeruar me çertifikaten perkatese.
4	Puseta kontrolli per ujra te zeza 80x80	Materjali beton , permasat 80x80
5	Tub HDPE SN8 d= 200mm (i brinjezuar)	Tubat PE=HD me mure dopio te brinjezuar sipas standartit EN 13476-1.Tubat do te prodhohen me material PE 80/100.Klasa e fortesise se unazave do te jete min SN8 dhe diametri i tubave 200mm.
6	Tub HDPE SN8 d= 315mm (i brinjezuar)	Tubat PE=HD me mure dopio te brinjezuar sipas standartit EN 13476-1.Tubat do te prodhohen me material PE 80/100.Klasa e fortesise se unazave do te jete min SN8 dhe diametri i tubave 315mm.
7	Tub Betoni Ø1000	Duhet te jene te perbera prej betoni cilesor, duhet te kete soliditet te larte.Permasat e diametrit 1000.
8	Tub Betoni Ø600	Duhet te jene te perbera prej betoni cilesor, duhet te kete soliditet te larte.Permasat e diametrit 600.
9	Hekur betoni 6-10mm	Te jete brenda standarteve te lejuara per perdorim, te mos jete i ndryshkur, si dhe te shoqerohet me çerfikaten e cilesise dhe te rezistences se tij.

10	Tub hekuri Ø 50mm	Te jete brenda standarteve te lejuara per perdorim, te mos jete i ndryshkur, si dhe te shoqerohet me çerfikaten e cilesise dhe te rezistences se tij, spresori 3mm.
11	Elektroda Ø2.5mm	Elektrodat e celikut duhet te jene te pershtatshme per procesin e saldimit ne materiale celiku permasat e elektrodes : Gjatesia 300 mm , Diametri 2.5 mm, Paketimi deri ne 4 kg.
12	Profile metalike (30X30)mm, T=3mm	Te jete brenda standarteve te lejuara per perdorim, te mos jete i ndryshkur, si dhe te shoqerohet me çerfikaten e cilesise dhe te rezistences se tij.
13	Kapak gize (80x80)mm, klasa C 250	materiali : gize; permasat 80x80cm; klasa C 250
14	Kapak gize (38x53.5)mm, klasa C 250	materiali : gize; permasat 38x53,5cm; klasa C 250
15	Kapak gize (40X40)mm, klasa C 250	materiali: gize; permasat 40x40 cm; klasa C 250

5- Blerje materjale për Platformat e Koshave.

Nr	Emertimi	Specifikimet teknike
1	Çimento 32.5 R	Çimentoja te jete e markes 32.5R, pa lageshtire, e mirepaketune thase 25kgdhe e shoqeruar me çertifikaten perkatese.
2	Zhavor	Të jetë i sigur dhe të mos përmbajë lëndë të huaja
3	Rane e lare lavatriçeje	Rere e lare ne lavatriçe te jete rere me madhesi kokrizash 0.06 mm–2mm.
4	Gelqere e shuar	Gelqere ne thase 5-8 kg per aplikime ndertimi.
5	Blloqe betoni 15x20x40mm	Duhet te jene te perbera prej betoni cilesor, duhet te kete soliditet te larte.Permasat duhet te jene sipas preventivit.
6	Hekur betoni Ø8mm	Te jete brenda standarteve te lejuara per perdorim, te mos jete i ndryshkur, si dhe te shoqerohet me çerfikaten e cilesise dhe te rezistences se tij.
7	Zgare metalike Ø6mm	Te jete brenda standarteve te lejuara per perdorim, te mos jete i ndryshkur, si dhe te shoqerohet me çerfikaten e cilesise dhe te rezistences se tij.

6- Blerje materjale për Trotuaret.

Nr	Emertimi	Specifikimet teknike
1	Stabilizant	Stabilizant tradicional - bazë standarte për shumicën e mbulesave për dekada të tëra, I nxjerre nga gurorët me përmasa 0.5mm.
2	Granil	Granil me permasa 0.5-3mm
3	Rane e lare lavatriçe	Rere e lare ne lavatriçe te jete rere me madhesi kokrizash 0.06 mm–2mm.
4	Çimento 32.5 R	Çimentoja te jete e markes 32.5R, pa lageshtire, e mirepaketune thase 25kgdhe e shoqeruar me çertifikaten perkatese.
5	Pllaka trotuari 6cm	Permasa 30x30cm, ngjyra grih e errët. Permasa 15x15 , ngjyra pane , trashesia 6.2 cm. Pjesa e ngjyrosur te jete beton

		me bojë çimentato 1cm. Pllaka të kenë të zmusuara buzet e sipërme të pllakes. Te kete nje qendrushmeri te larte ndaj abrazionit te jene sipas standarteve SSH EN 1338: 2003/AC2006
6	Bordura betoni 15x30x100	Permasa 15x100cm : Lartesia 30cm : Ngjyra grih
7	Bordura betoni 20x35x100	Permasa 20x100cm : Lartesia 35cm : Ngjyra grih
8	Bordura betoni 10x20x100	Permasa 10x100cm : Lartesia 20cm : Ngjyra grih
7- Blerje materiale për Rruget Rurale.		
Nr	Emertimi	Specifikimet teknike
1	Stabilizant	Stabilizant tradicional - bazë standarte për shumicën e mbulesave për dekada të tëra, I nxjerre nga gurorët me përmasa 0.5mm.
2	Gur kave	Gur me permasa te çregullta , dhe jo me te vogel se 20 cm
3	Rane e lare lavatriçe	Rere e lare ne lavatriçe te jete rere me madhesi kokrizash 0.06 mm–2mm.
4	Çimento 32.5 R	Çimentoja te jete e markes 32.5R, pa lageshtire, e mirepaketune thase 25kgdhe e shoqeruar me çertifikaten perkatese.
5	Inerte	Materjal i ngutë , te mos kete perzirje e lendeve te huaja te dekompozushme.
6	Çakull guroreje	Çakull guroreje me madhesi te gurëve jo me te medha se 10 cm.

8- Blerje materiale për Pastrimin.		
Nr	Emertimi	Specifikimet teknike
1	Qese mbeturinash 150 l	Perdorimi : Pastrim; kapaciteti mbajtes:150l;Paketimi cope:10pc; permasat:(80x110cm);ngjyra e zeze.
2	Doreza 1 perdorimshe	Materiali :elastik, masa :xl;xxl.

9- Blerje materiale për Sinjalistiken Horizontale		
Nr	Emertimi i produktit	Specifikimet teknike
1	Bojë e bardhë termoplastike	Koha e tharjes: ≤ 30 min, sipas standartit UNE135202. Ngjyrat: koordinatat e ngjyrave x,y sipas standartit UNE 135200 - 2 për ngjyrat. Faktori reflektues: $\beta \geq 0.80$, sipas standartit UNE 48073-2. Përshpejtimi i arritjes se ngjyrave ultraviolet: $\beta \leq 0.005$ dhe xy, brenda vlerave të vetë ngjyrës pa defekte dhe anomali sipërfaqësore, sipas standartit EN 1871.Rezistenca: bazike pa dëmtuar sipërfaqjen (në rast të aplikimit të drejtpërdrejtë në beton), sipas standartit EN1871 Dendësia relative: $\pm 2\%$ e vlerës së deklaruar $\{\rho = 2.00 \text{ (1.96 -2.04)}\}$ sipas standartit UNE135202/ EN ISO 2811-1. Faktori reflektues: ± 0.02 e vlerës së deklaruar $\{\beta = 0.86 \text{ (0.84 – 0.88)}\}$, sipas standartit UNE 48073-2

2	Bojë e kuqe termoplastike	Koha e tharjes: ≤ 30 min, sipas standartit UNE135202. Ngjyrat: koordinatat e ngjyrave x,y sipas standartit UNE 135200 - 2 për ngjyrat. Faktori reflektues: $\beta \geq 0.80$, sipas standartit UNE 48073-2. Përshpejtimi i arritjes së ngjyrave ultraviolett: $\beta \leq 0.005$ dhe xy, brenda vlerave të vetë ngjyrës pa defekte dhe anomali sipërfaqësore, sipas standartit EN 1871.Rezistenca: bazike pa dëmtuar sipërfaqjen (në rast të aplikimit të drejtpërdrejtë në beton), sipas standartit EN1871 Dendësia relative: $\pm 2\%$ e vlerës së deklaruar $\{\rho = 2.00 (1.96 - 2.04)\}$ sipas standartit UNE135202/ EN ISO 2811-1. Faktori reflektues: ± 0.02 e vlerës së deklaruar $\{\beta = 0.86 (0.84 - 0.88)\}$, sipas standartit UNE 48073-2
3	Bojë e verdhë termoplastike	Koha e tharjes: ≤ 30 min, sipas standartit UNE135202. Ngjyrat: koordinatat e ngjyrave x,y sipas standartit UNE 135200 - 2 për ngjyrat. Faktori reflektues: $\beta \geq 0.80$, sipas standartit UNE 48073-2. Përshpejtimi i arritjes së ngjyrave ultraviolett: $\beta \leq 0.005$ dhe xy, brenda vlerave të vetë ngjyrës pa defekte dhe anomali sipërfaqësore, sipas standartit EN 1871.Rezistenca: bazike pa dëmtuar sipërfaqjen (në rast të aplikimit të drejtpërdrejtë në beton), sipas standartit EN1871 Dendësia relative: $\pm 2\%$ e vlerës së deklaruar $\{\rho = 2.00 (1.96 - 2.04)\}$ sipas standartit UNE135202/ EN ISO 2811-1. Faktori reflektues: ± 0.02 e vlerës së deklaruar $\{\beta = 0.86 (0.84 - 0.88)\}$, sipas standartit UNE 48073-2
4	Tretës	Paketimi :0.75 l , hollimi:10-20% , koha e tharjes 1-2 orë
5	Fosfor	Paketimi: 15 kg
6	Kuarc	Ai i përket mineraleve Silikat-Tektosilikate dhe është oksid Silikon/, Paketimi me thse 15 kg dhe eshte ne forme pluhuri
7	Rrula 15 cm	Rulon 15 cm , per sinjalistike horizontale , Materjali qeleshe
8	Rrula 11 cm	Rulon 11 cm , per sinjalistike horizontale , Materjali qeleshe
9	Ngjitës, tenie	Materjali: Leter ngjitesë , Permasa 50 mm x 50 m.
10	Litar Ø-8, 1000	Litari prej poliestre me përmasë 8mm, ka një fushe përdorim të gjere ne ambjente të jashtme por edhe ne uje. Litari është rezistent ndaj ujit, vajit, naftës. Materiali prej poliestre e ben kete litare te kete qendrushmeri dhe me I lehte ne përdorim, si dhe mund te pastrohet lehte. Ngarkesa mbajtëse e lejuar

10- Blerje materiale për Ndriçimin

Nr	Emertimi i produktit	Specifikimet teknike
1	Puseta kontrolli (30x30x30)	Materiali: Polipropilen; Permasat:30 x 30 cm; Lartësia: 30 cm.
2	Tub kavidoto D.63mm	Materiali:PVC Diametri: Ø63 mm
3	Tub plastik Ø 200mm	Diametri: 200 mm; materiali plastik; diametri ne dalje: 200 mm; gjatesia: 3m; forma: I drejte.
4	Shina per kaseta metalike 40cm	Gjatësia: 2 m; gjerësia: 3,5 cm; thellesia: 7,5 mm; seksioni: 1mm ² ; materiali: çelik.

5	Automat monofaze 32 A	Nr poleve 1,Nr module 1, Rryma nominale 32 A, Klasa C
6	Ndricues LED Rrugor	Lloji i ndriçimit: Bardhë i ftohtë 4200 K, Lloji i llambave: LED, Tipi: Ndricues rruge Jetëgjatësia: 50000 Hrs, Gjerësia: 23.7 cm, Gjatësia: 68 cm, Fuqia: 100 W, Përfshihen llambat: Po, Thellësia: 9.2 cm Materiali: Metal / xham Shkalla e mbrojtjes: IP65
7	Leshues magnetik 40A	Tensioni i bobines 220V , Rrryma termike 40A,Nr pole 4, Nr module 4 , Kontaktet 1NO +1NC
8	Leshues magnetik 80A	Tensioni i bobines 220V , Rrryma termike 80A,Nr pole 4, Nr module 4 , Kontaktet 1NO +1NC
9	Automat 63A 3 Fazor ,4P	Nr poleve 4,Nr module 4,Rryma nominale 63A, Klasa C
10	Automat 32A 3 Fazor ,4P	Nr poleve 4,Nr module 4,Rryma nominale 32A, Klasa C
11	Automat 40A 3 Fazor ,4P	Nr poleve 4,Nr module 4,Rryma nominale 40A, Klasa C
12	Automat monofaze 16A	Nr poleve 1,Nr module 1,Rryma nominale 16A, Klasa C
13	Finter rrugor 16A(4hyrje)	Fotoelement (Rl Muzgu) Tipi : Sensor fotoelektrik Fuqia : 5500W Shkalla e mbrojtjes : IP44 Tensioni: 220-240V Rryma : 25A
14	Bulona per elektroda tokezimi	Materiali: Zink Tipi: Sistem tokezimi M8
15	Kabull FG7OR, Cu, S=3x1.5 mm	Materiali: Baker/Gome G16/PVC; Tipi: Kabell FG7OR; Ngjyra: Gri; Seksioni: 3 x 1.5 mm ²
16	Kabull Φ(4x10mm) Al	Kabllo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 4x10mm ²
17	Kabull Φ(4x16mm) Al	Kabllo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 4x16mm ²
18	Kabull FG7OR, Cu, S=4x6 mm	Materiali: Baker/Gome G16/PVC; Tipi: Kabell FG7OR; Ngjyra: Gri; Seksioni: 4 x 6 mm ²
19	Bazament siguresse	Morseteri Shtylle;Rryma nominale 25/63A;4Polar
20	Tel tokezimi bakri , Cu,1 x 10 mm	Materiali i izolimit: PVC R2;Temperatura e punës: +5°C - +60° C;Tensioni: N07VK-K 240V; Tipi: Percjelles elektrike
21	Shtylla metalike per ndriçim H=4.5m, d=160mm	Materiali: xingato; lartesia H=4.5m; diametri 160mm.
22	Shtylla metalike per ndriçim H=7m, d=160mm	Materiali: xingato; lartesia H=7m; diametri 160mm.
23	Shtylla metalike per ndriçim H=9m, kod PAICC-3	Materiali: xingato; lartesia H=9m;diametri 160mm
24	Krah shtylle metalike KRH-MSI 1500/1500/10	Materiali : xingati,I kalandruar.sipas standarteve.
25	Krah shtylle metalike dyshe KRH-MSI 1500/1500/11	Materiali : xingati,I kalandruar.sipas standarteve.

26	Kapak shtyllash	Materiali:çelik; me gomina izoluese.
27	Sigures shtyllash	Siguresa; gjatesia 20mm;gjeresia:5mm; materiali: porcelan/metal;tensioni:230-400V
28	Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar	Elektrode tokezimi 50x50x3mm, 1.5m; gjatesia:150;gjeresia:5;seksioni(mm ²);materiali :çelik I galvanizuar.
29	Tiranta (kapse per kabull)	Përcjellësi I ankoruar[mm] 4x16-95;Ngarkesa [kn] 5
30	Kabul ABC gershet (4x16mm) Al	Kabllo elektrike – Izoluar nga polietileni i ndërlidhur – Paketa ajrore – Për tensione pune deri në dhe duke përfshirë 0,6/1(1,2) kV – Përçues alumini
31	Tub xingato Ø40	Materjal Xingato: Diameter 40 mm: spresor 3mm
32	Qafore Shtylle	Materjal xingat Ø140 mm , per tu fiksuar ne shtyllen e betonit
33	Konjuktur	Seksioni i percjellesit(mm ²);Percjellesi i cveshur 16-95 , Percjellesi i linjesABC 16-95; Buloni 2xM8;Momenti I shtrengimit(Nm) 16
34	Kasete metalike	Materiali:Metal Përmasat: 600x400x200 cm
35	Izolant	Tipi: Nastro Izolant, gjatësia 10 m x gjeresia 15 mm x trashesia 0.13 mm. Materjal PVC
36	Mbrojtes mbitensioni dhe rrufeje	Ngarkesa 40A;Imax[kA] 10; In[kA] 20; Nr poleve 4

11- Blerje materjale për Sinjalistiken Vertikale			
Nr.	Kodi	Emërtimi i tabelës	Specifikimet teknike
